VENDIM
Nr.1686, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR.414, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Përmasat e pronave nr.262, 262/1, 262/2, 262/3, 262/4, 262/5, 262/6, 262/7, 262/9 e 262/11, në bashkinë Lezhë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në listën e inventarit të pronave të bashkisë Lezhë shtohen pronat me nr.1-216, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pronat e përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i transferohen bashkisë Lezhë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lezhë — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
81	Terrene sportive	Në pronësi
12-24,27-75,77-80,82-193,195-198,200-203,205,206,207-216.	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte sip të gjelbëruara) dhe shërbime publike	Në pronësi